



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



T R A N S K R I P T

i mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 18.01.2018,
duke filluar në orën 10:00.

Kryesuesi, Shefki Gashi: Mirëmëngjesi!

Mirë se keni ardhur në takimin e dytë të Kuvendit komunal të Prishtinës!

Përshëndetje për kryetarin,

Nënkryetarin,

Ekzekutivin,

Përshëndetje për të gjithë asamblastët,

Për pjesëmarrësit tjerë, qofshin OJQ, qofshin organizata ndërkombëtare,

Përfaqësuesit e pushtetit lokal dhe

Përshëndetje për mediat, dhe ato është mirë me u skajuar pak. Ne jse, ju xhiromëni, mua kështu si kryesues, nuk ka problem, por lëshojeni pak rrugën të shohin edhe tjerët se dikush e kërkon fjalën e unë nuk e shoh, mandej njerëzit hidhërohen.

Po procedojmë me rendin e ditës, por para se me hy në ren të ditës, i kemi tre asamblastë të rinj që duhet me e dhënë betimin, është **Mimoza Sylejmani**, në vend të **Nora Kelmendit**, **Qëndrim Sahiti**, në vend të **Arben Vitisë** dhe **Milot Podvorica**, në vend të **Genc Bashotës**. Prandaj i thërras këta që të ngritën në këmbë, a po ua lexon ti djalë betimin, ose dilni këtu një nga një, ose lexoje ti djalë betimin.

A e ke tekstin për betimin?

Urdhëro!

Unë, emrat e juaj i thoni, betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë. Betohem!

Kryesuesi: Urime!

Ju faleminderit!

Vazhdojmë me mbledhje, ju e keni marrë rendin e ditës, për këtë mbledhje është propozuar ky

R E N D D I T E:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese;
2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
3. Propozimvendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
4. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës;
5. Pyetje dhe përgjigje;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi: Po, po ke të drejtë Halim, edhe unë ua tërhoqa vërejtjen, po sa t'i kryejnë xhirimet ndoshta ka mundësi me dalë më prapa atje dhe me e lëshuar rrugën, se kjo pjesa realisht nuk po duket hiq, nuk mund të punojmë, për ndryshe, po dëgjo, ne jemi për këta këtu, jo këta për neve. Ju lutem, thirri ti djalë! A je ti zëdhënës? Thirri mediat, gjeju vendin ti.

A ka dikush diçka rreth rendit të ditës?

Nuk ka.

Kush është për rendin e ditës, ju lutem?

Ju faleminderit!

Vazhdojmë.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese.

Kryesuesi: A ka dikush diçka rreth ekstraktit të procesverbalit?

Nëse jo, unë i kam dy fjali.

Në seancën e kaluar është bërë pak një gabim, se është dashur që të themelohet edhe komisioni për verifikim të mandateve, por është kryer betimi dhe ajo punë ka përfunduar, prandaj duhet që të paktën të kemi kujdes në zbatimin e rregullave ligjore.

Ju faleminderit!

Kush është për miratimin e ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar?

Ju faleminderit!

Shkojmë tutje.

Pika e dytë

Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi: Procedura për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit kërkon që të formohet një komision zgjedhor, i cili do të përbëhet prej 5 anëtarëve. Sipas rregullës, shkojnë partitë që kanë grupin më të madh të asamblesë komunale, do të thotë një nga VV-ja, një nga LDK-ja, një nga PDK-ja, një nga AAK-ja dhe një nga AKR-ja.

Ju lutem, propozimet prej shefave të grupeve parlamentare.
Urdhëro!

Diskutuesja nuk është prezantuar: VV-ja propozon z. Genc Sherifi.

Kryesuesi: Nga VV-ja Genc Sherifi.

Genc, dil atje ulu.

Nga LDK-ja?

Mustafë Krasniqi.

Nga PDK-ja?

Migjen Shala.

Nga AAK-ja?

Valbona Ajeti.

Nga AKR-ja?

Rifat Deri.

E lus administratën, shërbimin e Kuvendit, që edhe komisioni të tërhiqet t'i bëjnë përgatitjet, gjegjësisht duhet me shkuar me propozimet njëherë, okej, vazhdojmë.

VV-ja çfarë propozimi ka?

Diskutuesja nuk është prezantuar: Në emër të koalicionit VV, AKR, AAK, Nisma dhe Lëvizja për Bashkim, për kryesues të Kuvendit propozojmë z. Agim Kuleta.

Kryesuesi: Agim Kuleta.

LDK-ja?

Halim Halimi: Grupi i këshilltarëve të LDK-së propozon z. Shefki Gashi.

Kryesuesi: Bravo!

PDK-ja?

Nuk keni.

Të tjerët e kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre.

Po, Nisma, urdhëro Malisheva, a keni propozim?

Jo.

Sekretaria e Kuvendit emrat i ka, le të fillojë me përgatitjen e fletëvotimeve, ia dorëzoni komisionit, komisioni i verifikon ato, i kontrollon dhe vazhdojmë.

Po e japim një pauzë të shkurtër?

Halim, a po e bëjmë një pauzë, a po e vazhdojmë pikën tjetër të rendit të ditës?

Okej, pauzë pesë minuta.

Kryesuesi: Paska vdekur ish-kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Sherafedin Sylejmani. Ti nuk e mban në mend, asnjë se mbani në mend këtu, Sherafedin Sylejmani, ish-kryetar i Komunës së Prishtinës, a guxojmë me mbajtur një minutë heshtje për të? Mustafë, këqyrni këto fletëvotimet a janë në rregull?

Diskutuesi nuk është prezantuar: Kryesues, fletëvotime janë 55, i kanë bërë edhe 5 shtesë, që po ia dërgoj komisionit këtë.

Kryesuesi: Djalë, paska vdekur ish-kryetari i Komunës së Prishtinës, Sherafedin Sylejmani, ka qenë kryetar në vitet e 60-ta, një qytetar i Prishtinës, burrë i mirë.

E provova a po bënë zilja.

Merre ti këtë e dil qaty e thirri një nga një.

Ju lutem, po vazhdojmë, Bllaca i thërret me emër asamblistët me radhë, e merrni fletëvotimin. Ku është kabina me votuar? Okej, kabina qenka atje dhe me radhë votoni dhe i futni në kutinë e votimit.

Fillojmë, Bllaca.

Osman Bllaca: E thirri kandidatin p.sh. i pari vjen Mirsad Vitia, le të përgatitet Qëndrim Sahiti, Mirsadi vjen voton, e kryen procesin e votimit, pastaj vjen Nol Nushi, le të përgatitet Eman Rrahmani, Drilon Pireva, le të përgatitet Vjosa Hamiti-Krasniqi, Milot Podvorica, le të përgatitet Egzon Azemi, Yll Rugova, le të përgatitet Genc Sherifi, Ardian Berisha, le të përgatitet Besnik Mujeci, Visare Gashi, Mimoza Sylejmani, Leonora Shabani-Bajraktari, Valbona Petrovci, Vala Peshku, Mustafë Krasniqi, Haki Dragusha, Halim Halimi, le të përgatitet Sami Salihu, Vlora Dumoshi, pas Vlorës Shefqet Osmani, le të përgatitet Agim Gashi, Sokol Havolli, Shefki Gashi, le të përgatitet Jeta Rafuna-Hasani, le të përgatitet Kushtrim Sopa, Milazim Vitia, le të përgatitet Elmire Nikçi-Rexha, Naime Osmani, Fiknete Bejta, Blerand Stavileci, Uran Ismaili, pastaj Migjen Shala, Leutrim Retkoceri, le të përgatitet Florida Canolli, Kumrije Shabani-Ramadani, le të përgatitet Sokol Berisha, Fadil Gashi, Yll Bogaj, Valbona Ajeti, Suzan Kika, le të përgatitet Vesel Makolli, Sami Boroci, le të përgatitet Arbenita Murseli, Adelina Fazliji, le të përgatitet Agim Kuleta, le të përgatitet Bukurie Canolli, pas Bukuries Rifat Deri dhe Baton Dushi.

Kryesuesi: D.m.th. është kryer a?

I lutem komisionit që të procedojë me punën e mëtutjeshme, që të jetë sa më transparente, sa më e dukshme, nuk është ku me e ditur sa punë e madhe, aty janë 51 fletëvotime.

Shiko, Selim, unë jam kanë nënkryetar vetë, veç nuk e dua atë emër, nuk e dua, i dyti, këqyre zori të gjitha i bënë, por nuk është post i mirë, kur është njeriu ngushtë nuk ka qare, idaria të qon gjithkund.

Hajde, Migjen, çka po pështillni aty më, Migjen?

Hajde ju lutem komisioni, le të del dikush, kush është prej komisionit?

Ju lutem anëtari i komisionit, qohu ti Genc a cili jeni.

Genc Sherifi: Përshëndetje të gjithëve,
Përshëndetje i nderuari kryesues i kësaj seance!
Atëherë, komisioni i ka marrë fletëvotimet dhe gjithsej kanë votuar 51 asamblastë, prej tyre 46 vota të vlefshme, të pavlefshme 5 vota.
Sipas votimit tuaj, për kandidatin Agim Kuleta kanë votuar 27 asamblastë.
Ndërsa për kandidatin Shefki Gashi kanë votuar 19 asamblastë.
Atëherë i urojmë zotit Agim Kuleta detyrën.

Kryesuesi: Faleminderit!

Faleminderit prej komisionit!

Urime z. Kulet!

Ju kërkohet që ta merrni pozitën e kryesuesit të Kuvendit, duke ju dëshiruar sukses.

Veç a më lejoni dy fjali. Paska vdekur ish-kryetari i Kuvendit komunal të Prishtinës i viteve të 60-ta, gjegjësisht po shkruan këtu 66-67, mua më kujtohet mirë Sherafedin Sylejmani, nëse nuk prish punë, është mirë dhe nder me i bërë nja gjysmë minute nderim.

Ju faleminderit!

Kryesuesi, Agim Kuleta: Të dashur qytetarë të Prishtinës,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit komunal të Prishtinës,

Kryetar Ahmeti,

Drejtorë të nderuar,

Të nderuar përfaqësues të mediave dhe ju të pranishëm,

Fillimisht dua të ju falënderoj të gjithë juve anëtarë të këtij kuvendi, që më dhatë besimin me qenë kryesues i Kuvendit komunal të Prishtinës, gjithashtu dua të uroj secilin prej jush, pavarësisht subjektit politik që i takoni, për rezultatin në zgjedhje dhe detyrën e re si anëtarë të këtij kuvendi. Kjo përbërje e kuvendit është reflektim i asaj që kanë zgjedhur qytetarët e Prishtinës, këta qytetarë gjatë ushtrimit të së drejtës së tyre të votës janë përcaktuar për njerëz të ndryshëm dhe subjekte politike të ndryshme. Ata kanë vendosur ta votojnë dikë qoftë për shkak të personalitetit të tij, qoftë për shkak të përkatësisë partiake, apo edhe për shkak të të dyjave bashkë, pra ata kanë votuar ndryshe nga njëri-tjetri. Por, pavarësisht nga ky fakt, prapa këtyre përzgjedhjeve të ndryshme nga qytetarët tanë qëndron motivi i njëjtë, ata e duan një qytet të zhvilluar, funksional dhe të bukur. Prandaj ne si përfaqësues të tyre, sa herë që të thirrmi në interesat e votueseve tanë, duhet ta kemi të qartë se po thirrmi në interesat e të gjithë qytetarëve të Prishtinës, kjo edhe duhet të na bëjë të përgjegjshëm për punët dhe veprimet tona të përditshme.

Unë jam i bindur se edhe secili prej jush pajtohet me faktin se, gjërat që na bashkojnë janë më të mëdha e më të rëndësishme sesa ato që mund të na ndajnë. Ne na bashkon interesi i Prishtinës dhe qytetarëve të saj, ndërsa mund të na ndaj mënyra se si e shohim realizimin e këtyre interesave. Prandaj, duke besuar fuqishëm në këtë, si kryesues i këtij kuvendi, do të përpiqem maksimalisht që ta kryej punën time në mënyrë sa më profesionale, do të jem i hapur dhe bashkëpunues me secilin prej jush, në funksion të mbarëvajtjes së punës në këtë institucion dhe në të mirë të qytetarëve të komunës tonë të përbashkët. Por për këtë qëllim unë nuk do të kërkohet nga ju një unitet me çdo kusht, sepse kusht për ta arritur një

unitet përmbajtës është pikërisht që të mos ketë kushte. Gjithashtu edhe për një arsye unë kurrë nuk do të kërkoj unitet me çdo kusht, sepse jo gjithmonë mospajtimet janë shkaktar të ndasive midis njerëzve. Ndasitë shpeshherë janë pasojë e unitetit të rrejshëm dhe të detyrueshëm, atij uniteti ku palët e kundërta pajtohen që të mos dalin në publik kundërshtimet, gjë që krijon një paqe të rrejshme publike, e cila në realitet nuk sjellë tejkalim të interesave të kundërta, por pakësim të asaj që mund të dëgjohet në publik, pra jashtë rrethit të tyre.

Ajo që unë besoj që është kryesorja në funksionimin e mirë të këtij kuvendi, është baza mbi të cilën ngrihen qoftë uniteti, qoftë ndasitë, e kjo bazë përbëhet nga parimet, konstruktiviteti, qëllimi i mirë, përgjegjësia dhe ndershmëria. Kur këto ekzistojnë tek secili prej nesh, atëherë mungesa e unitetit nuk nënkupton domosdo edhe mungesë bashkëpunimi, përkundrazi, nënkupton që përmes kundërshtimeve dhe debateve konstruktive, të përgjegjshme e qëllim mira, të përsoset një projekt dhe të nxirret një rezultat edhe më i mirë. Pra, më mirë një pluralizëm i sinqertë, sesa një unitet i rrejshëm, këtë gjë besoj që do ta kemi parasysh secili prej nesh, gjatë punës sonë të përbashkët në këtë institucion.

Të nderuar anëtarë të këtij kuvendi, qytetari ynë sot ka më së shumti nevojë për punë me nder dhe përkushtim në punë, duke besuar se i kemi këto dy cilësi, dhe na kanë zgjedhur neve prej shumë kandidatëve të tjerë që i ka pas përpara vetes, prandaj kjo nevojë e qytetarit duhet të jetë detyrë për ne, të cilën uroj që ta kryejmë sa më mirë që është e mundur.

Faleminderit edhe njëherë dhe punë të mbarë për të gjithë!

Atëherë, shkojmë tutje.

Pika e tretë

Propozimvendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi: Atëherë, unë do të kërkoja një takim me përfaqësuesit e subjekteve politike që janë këtu dhe gjithashtu do të ofroja një pauzë prej 10 minutave për të tjerët, derisa ne ta kryejmë këtë proces.

Faleminderit!

Kryesuesi: Atëherë, konstatoj se e kemi kuorumin dhe mund të vazhdojmë, në sallë janë dyzet e shtatë asamblistë.

Ne pas takimit me përfaqësuesit e subjekteve politike i propozuam anëtarët e këtij Komiteti nga secili subjekt, të cilët unë do t'i lexoj me radhë, dhe pastaj do të ndjekim procedurën e votimit.

Agim Kuleta shkon ex officio, dihet, për shkak të pozitës së kryesuesit.

Nga LVV shkon Visare Gashi, Vala Peshku, Milot Podvorica dhe Genc Sherifi.

Nga LDK shkon Halim Halimi, Agim Gashi dhe Jeta Rafuna.

Nga PDK shkon Blerand Stavileci.

Nga AAK shkon Fadil Gashi.

Nga AKR - AA shkon Sami Boroci.

Atëherë, shkojmë me procedurën e votimit.

Kush është për?

Konstatojmë se në mënyrë unanime miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Politik dhe Financa, si komitet i përhershëm, me përbërjen që e lexuam pak më parë.

Faleminderit!

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës.

Pika e katërt

Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi: Ndërmarrjet janë: ngrohtorja e qytetit “Termokos”, Ndërmarrja Publike Banesore, kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi”, ndërmarrja komunale “Hortikultrua”, ndërmarrja publike “Trafiku Urban”, ndërmarrja publike “Sport - Marketing”, Stacioni i Autobusëve dhe “Prishtina Parking”.

Atëherë, vazhdojmë me procedurën. I ftoj përfaqësuesit e subjekteve politike që t’i paraqesin propozimet e tyre.

Leonora Shabani - Bajraktari - LVV: Lëvizja Vetëvendosje së bashku me koalicionin tonë:

- për ndërmarrjen “Termokos” kemi propozuar Nol Nushin - LVV dhe Arbenita Murselin - AKR-AA;
- për ndërmarrjen “Sport - Marketing” kemi propozuar Adelina Fazlijin - AKR-AA dhe Besnik Mujecin - LVV;
- për ndërmarrjen “Pastrimi” kemi propozuar Sokol Berishën - AAK dhe Vjosa Hamitin - LVV;
- për ndërmarrjen “Hortikultura” kemi propozuar Valbona Ajetin - AAK dhe Leonora Shabani - Bajraktarin - LVV;
- për Ndërmarrjen Publike Banesore kemi propozuar Egzon Azemin - LVV dhe Qëndrim Sahitin - LVV;
- për Stacionin e Autobusëve kemi propozuar Mirsad Vitinë - LVV dhe Rifat Derin - AKR-AA;
- për ndërmarrjen “Trafiku Urban” kemi propozuar Adrian Berishën - LVV dhe Bukurie Canollin LB;
- për “Prishtina Parking” kemi propozuar Eman Rrahmanin LVV- dhe Drilon Pirevën LVV.

Këta janë emrat e propozuar nga LVV, së bashku me koalicionin.

Kryesuesi: Vazhdojmë me propozimet.

E ftojme Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Halim Halimi – LDK: LDK ka këto propozime:

- për ngrohtoren e qytetit “Termokos” propozojmë Milazim Vitinë;
- për Ndërmarrjen Publike Banesore propozojmë Sami Salihun;
- për kompaninë rajonale të mbeturinave “Pastrimi” propozojmë Mustafë Krasniqin;
- për ndërmarrjen “Hortikultura” propozojmë Elmira Nikqin;
- për ndërmarrjen “Trafik Urban” propozojmë Shefki Gashin;
- për ndërmarrjen “Sport Marketing” propozojmë Kushtrim Sopën;
- për Stacionin e Autobusëve propozojmë Haki Dragushën;
- për ndërmarrjen “Prishtina Parking” propozojmë Shefqet Osmanin.

Kryesuesi: Faleminderit!

Nga Partia Demokratike e Kosovës.

Blerand Stavileci – PDK: Propozimet nga PDK janë si në vijim:

- për ngrohtoren e qytetit “Termokos” propozojmë Migjen Shalën;
- për Ndërmarrjen Publike Banesore propozojmë Florida Canollin;
- për ndërmarrjen “Trafikun Urban” propozojmë Kumrije Shabani – Ramadanin;
- për Stacioni i Autobusëve propozojmë Leutrim Retkocerin;
- për ndërmarrjen “Prishtina Parking” propozojmë Leutrim Retkocerin.

Kryesuesi: Nuk ka mundësi të propozohet i njëjti person për dy ndërmarrje.

Atëherë shkojmë me votim për propozimet që janë bërë sipas radhës.

Votojmë për propozimin e koalicionit LVV- AAK – AKR – LB – A – Nisma.

Kush është për?

30 janë për.

A ka kundër?

Abstenim?

Mundemi me shkuar edhe kandidat për kandidat, por praktikisht ajo që votohet 30, votohet 30 sepse është propozim i koalicionit.

Urdhëro!

Agim Gashi: Ju jeni kryesues dhe nuk mund të paragjykoni, por duhet t’i respektoni procedurat sipas udhëzimit të Zyrës ligjore, prandaj të këshilloj që t’i respektohet procedurat sipas udhëzimeve të Zyrës ligjore.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Atëherë do të konsultohemi me Zyrën ligjore. Unë mendova të jem më praktik me gjithë ju, por në rregull, vazhdojmë.

Jemi mësuar me maratona, jemi të përgatitur.

Halim Halimi: Kërkoj falje, a mund të bëhet një ndryshim tek ndërmarrja "Hortikutura", në vend të Elmira Nikqit të jetë Fitnete Bejta.

Kryesuesi: Atëherë në emër të Zyrës ligjore ftoj z. Fatos Dibra.

Fatos Dibra: Përshëndetje për të gjithë!

Këto vendime d.m.th. të caktimit të aksionarëve nuk është e nevojshme me u bërë veç e veç, ka edhe precedent për vitet e kaluara, të cilat janë votuar të gjithë për menjëherë. Nuk ka ndonjë farë problemi të caktuar nëse shkojmë dhe i votojmë të gjithë përnjëherë.

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, z. Havolli!

Sokol Havolli: Është mirë Zyra ligjore me na treguar nëse ka procedurë që e rregullon këtë, sepse në bazë të precedentëve nuk rregullohen çështjet që i takojnë natyrës procedurale, dhe në rregull është gjithsecila çështje në këtë drejtim, por nëse ka procedurë për këtë, atëherë duhet të na njoftojë Zyra ligjore për atë dhe të na tregojë procedurën se si duhet të shkohet në votim.

Faleminderit!

Fatos Dibra: Edhe vendimi i caktimit të aksionarëve, d.m.th. e kemi një vendim për të gjithë, kështu që nuk ka arsye të shkojnë veç e veç, se për këtë arsye do t'i kishim bërë sa janë, tetë vendime veç e veç. Do të thotë nuk ka ndonjë farë problemi procedural ligjor lidhur me këtë çështje.

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, z. Agim Gashi!

Agim Gashi: Mua më vjen keq prej përfaqësuesit të Zyrës ligjore që nuk e udhëzon proceduralisht se si duhet të veprohet, sepse pavarësisht a humb, apo nuk humb pala propozuese, ju jeni i obliguar që ta procedoni. Edhe një votë nëse e merr pala, ti je i obliguar me e proceduar, dhe ne asgjë nuk kërkuam vetëm respektim të procedurës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, z. Havolli!

Sokol Havolli: Edhe çështjet e vendimeve, siç është edhe vendimi i propozuar, vijnë në bazë të një procedure, kështu që edhe kjo çështje e ka procedurën e vetë, duhet ta ketë diku, ju jeni përgjegjës me na treguar se cila është procedura që shkohet me votim të individëve që janë propozuar, me vendim të secilës ndërmarrje një nga një, apo me

vendim të përgjithshëm, por duhet të jetë i mbështetur në një procedurë që është aprovuar ose nga një kuvend, ose nga një rregullore që është e miratuar edhe prej institucioneve relevante.

Kryesuesi: Urdhëro, kryetar!

Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës: Faleminderit të gjithëve! Për shkak edhe të përvojës ndoshta katërvjeçare në këtë Kuvend komunal, ka ndodhur që, mundet këtu me më korrigjuar edhe z. Halimi, më duket se nja pesë herë i kemi votuar aksionarët, gjithmonë kanë shkuar në grup sa i përket procedurave, vendimet vijnë si propozime në Kuvendin komunal dhe ose votohen, ose nuk votohen.

Në këtë rast ka marr 30 vota dhe çdo venim i Kuvendit komunal i nënshtrohet shqyrtimit të obligueshëm të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Pra në momentin që ky vendim nënshkruhet nga kryesuesi, ashtu siç është bërë, i dërgohet Ministrisë dhe brenda 15 ditëve ata thonë kjo është e ligjshme apo është e kundërligjshme.

Ju kujtoj se në të kaluarën është kontestuar në Ministri kjo mënyrë e votimit dhe Ministria na e ka kthyer që nuk ka asnjë procedurë që e ndalon këtë votim në bllok, çdo herë e ka kthyer vendimin në grup si vendim të ligjshëm. Ne mundemi me e bërë edhe një nga një, mundemi me e qitur në procedurë të votimit, siç po thotë z. Agim Gashi, propozimin për me u votuar një nga një.

Kryesues, mundesh me bërë atë, por tash ke një votë prej 30 anëtarëve që kanë votuar për një vendim, vazhdojmë me mocionet e tjera, përndryshe çdo vendim që është i jashtëligjshëm, na e kthen Ministria dhe thotë votojeni edhe një herë.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Halim!

Halim Halimi: Dihet që ky vendim në letër është, të gjithë emrat janë qitur në një letër, një vendim është, mirëpo ky vendim është me emër dhe mbiemër, unë ndoshta jam për dikë, por ndoshta për dikë nuk kam jam për me qenë në komision të aksionarëve në ndërmarrje, kështu që duhet të shkohet veç e veç.

Ne nuk mundemi me e përcjellë praktikën e mëparshme të vendosim këtu, t'ia qojmë Ministrisë së Pushtetit Lokal le të na e kthen të ligjshme apo të paligjshme. Ne duhet të punojmë këtu me ligj.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Stavileci!

Blerand Stavileci: ... të kaluarën, pa hyrë në atë se nuk po e konteston askush ligjshmërinë, por me pasur një përmbushje procedurale, por edhe përmbushje politike të vullnetit politik që shfaqet këtu, mendoj se vendimi është i tillë dhe parasheh të tetit, nuk ka asnjë problem, sepse në atë moment nëse këtu votohet edhe ka një

pajtueshmëri, në vend se me zgjat dy minuta, zgjat tetë minuta, por s'ka nevojë pastaj me shkuar në Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal.

Mendoj që është më mirë me shkuar një nga një emrat, dihen cilët janë aksionarët, nuk e konteston askush ligjshmërinë, edhe mendoj se është parim shumë i mirë me u zbatuar edhe në të ardhmen.

Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Atëherë, shpresoj që ke diçka më ndryshe.

Urdhëro, z. Gashi!

Shefki Gashi: Për gjithçka është një ligj, me një numër të caktuar një nen, një pikë, një aline, Zyra ligjore e ka për detyrë me e nxjerrë dhe me e lexuar Ligjin, alinenë, nën pikën 1,2,3,4,5, jemi apo nuk jemi në rregull.

Për mua nuk është ajo punë që tha kryetari, që të qojmë në Ministri, atje gjysma janë nxënësit e mi, e me më korrigjuar mua atje a e kam bërë mirë apo jo!

Kështu që unë kam aftësi vet këtu me e rregulluar këtë çështje, me të gjithë këtu çka jemi, prandaj nuk ka nevojë me u ngutur me kapërcyer, me korrigjuar dikush, por po e korrigjojmë vet. Nëse je i papërgatitur ti i Zyrës ligjore, trego zotëri, më falni, Ligjin nuk e kam lexuar, nuk bëhet nami edhe e lëmë për herën tjetër.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Unë i dëgjova diskutimet e juaja, propozimi tjetër i juaji është me shkuar një nga një, atëherë unë për hir të procedurës, do ta hedh në votim propozimin e juaj.

Kush është për propozimin e LDK-së që të votohet një nga një?

Propozimi është dhe propozimin e hedha në votim.

Shefki Gashi: ... siç po thua ti, tash ne nuk e kemi, ne nuk e kemi konkluduar me shkuar nga dy, ne menduam se po i shtimë rend dhe cili të marrë vota më shumë të shkon tutje

Kryesuesi: Por për procedurë diskutuam ne, vetëm mos te përsëritim.

Për procedurë ne diskutuam, unë e hedh në votim propozimin.

Kush është për propozimin e LDK-së?

Atëherë, unë interpretimin e Zyrës ligjore e kam dhe punoj në bazë të interpretimit të Zyrës ligjore.

Agim Gashi: O zotëri, ti nuk e ke hedh në votim propozimin e dy subjekteve politike, pavarësisht sa vota i marrin.

Kryesuesi: Por nuk e latë për me vazhduar procedurën, nuk e lejuat me vazhduar procedurën, unë desha me e hedhë në votim, por ju thatë jo.

Atëherë, unë e kam interpretimin e Zyrës ligjore, unë veproj në bazë të interpretimit të Zyrës ligjore dhe ata janë të thirrur me interpretuar këtu.

Sa i përket asaj që e tha z. Stavileci, është rregull që të gjitha vendimet që merren këtu shkojnë ashtu kështu në Ministri për të marrë pëlqimin. Prandaj, duke qenë se kjo më shumë është çështje procedurale ligjore, këtu atëherë ne do ta marrim qëndrimin e Ministrisë dhe do të veprojme në përputhje me atë qëndrim.

Atëherë, ne konsiderojmë se është miratuar vendimi për caktimin e anëtarëve në Komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike në Komunën e Prishtinës, sipas propozimit të dhënë nga koalicioni i LVV-së dhe të tjerat.

Kalojmë në pikën e pestë.

Pika e pestë

Pyetje dhe përgjigje

Kryesuesi: A ka pyetje?

Nuk ka pyetje.

Kalojmë në pikën e gjashtë.

Pika e gjashtë

Të ndryshme.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Ismaili!

Uran Ismaili: Faleminderit, kryesues!

Së pari, urime edhe ty për pozitën!

Ju dëgjova me vëmendje gjatë fjalimit dhe u duk një fjalim i cili zotohet për një mundësi të barabartë të gjithë deputetëve, duke konsideruar se ka një reflektim të votës së qytetarëve.

Konsideroj se mundësinë e keni, që në fillim unë propozoj që grupet parlamentare të cilat nuk kanë zyre fare në Komunën e Prishtinës, kanë ardhur me votë të qytetarëve, nuk kanë ardhur d.m.th. vetëm ta zënë një vend këtu. Konsideroj se duhet ta bëni një hap të tillë, është praktikë demokratike që të paktën të kenë zyrë, në kuvendet komunale të kenë zyre të veta, e të mos endemi korridoreve ose të na thuhet një arsytim që ka qenë më duket më herët, ka diku një sallë të lirë edhe vendosuni aty ku është salla e lirë.

Prandaj, besoj që edhe për frymën demokratike në Kuvend komunalë të Prishtinës duhet të veproni menjëherë.

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Faleminderit!

Atëherë, ne do ta diskutojmë këtë çështje me ekzekutivin dhe shpresoj se do ta gjemë një zgjidhje sa më shpejtë që është e mundur.

Urdhëro, z. Agim Gashi!

Agim Gashi: Tani kam një informacion që në lagjen "Dardania", adresën e saktë nuk e di, blloku i parë, hyrja nr. 4, ka probleme me kanalizimin dhe podrumet e ndërtesës janë të mbushura me fekale.

Ka shumë ditë që po kërkohet ndihmë nga Komuna dhe ekzekutivi nuk arrin ta sanojë gjendjen, ku ajo është gjendje emergjente për ata banorë që jetojnë aty.

Me sa unë kuptova, Komuna nuk ka të kontraktuar asnjë kompani për mirëmbajtjen e kanalizimeve, përkatësisht në ato raste angazhohen kompanitë që pastrojnë kanalizimin atmosferik, pastrojnë kolektorët e qytetit dhe në raste të nevojave angazhohen nëpër objektet të institucioneve dhe të objekteve të përbashkëta të banimit, kur qytetarët nuk kanë mundësi t'i zgjidhin ato probleme.

Ju kisha lutur që ekzekutivi ta evidentojë dhe të ndërhyjë menjëherë se ajo është situatë emergjente.

Faleminderit!

Kryesuesi: A ka dikush tjetër?

Urdhëro, të lutem!

Leutrim Ratkoceri – PDK: Përshëndetje për të gjithë!

Fillimisht, urime për pozitën edhe për kolegët për pozitën e reja.

Desha të ndërlihem pak me këtë votimin e fundit për aksionarët. Ju kisha lutur që të bëhen publike CV-të e këtyre aksionarëve që janë, sepse edhe qytetarët duhet të shohin një transparencë më të madhe prej këtij Kuvendi, dhe pastaj të reflektojë kjo edhe tek drejtorët e këtyre ndërmarrjeve publike komunale, e jo si herën e kaluar të vijnë drejtorë nga qytetet e tjera dhe të mundohen që t'i zgjidhin problemet e qytetarëve të Prishtinës.

E marrim si shembull njërin prej tyre ndoshta, në Ndërmarrjen Publike Banesore, e kemi atje ndoshta vijnë njerëz tjerë nga Malisheva apo qyteteve tjera, e promovojnë se merren me rregullimin e ashensorëve në kryeqytet, e ndoshta nuk i kanë 5-6 vjet që jetojnë në Prishtinë dhe nuk i njohin këto probleme.

Për këtë ju kisha lutur, z. kryesues, e keni edhe Rregulloren për transparencë, e cila juve posaçërisht ju obligon që të jeni bashkërisht sa më transparent para qytetarëve të Prishtinës.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Dikush tjetër?

Urdhëro, znj. Osmani!

Naime Osmani: Përshëndetje për të gjithë.

Edhe unë e kam një rast thuajse emergjent, ku para një muaj dite e kam bërë kërkesën, nuk i ka një muaj, se afatin zyrtar po donë me e respektuar. Në fshatin Besi, në vitin 2016 e kanë rregulluar një pjesë të kanalizimit dhe i kanë shkuar përgjatë rrugës.

Këtë vit komplet kah shkojnë ato gypat e kanalizimit është shembur rruga, gjë që familjarët, d.m.th. banorët e atyre shtëpive nuk kanë qasje me automjete te shtëpitë e tyre përveç se në këmbë, edhe unë e konsideroj këtë se është emergjente dhe duhet të rregullohet.

Unë kërkesën e kam bërë në drejtori, edhe po më duket se kanë konflikt interesi, nuk po e di a është në kompetencë të Drejtorisë së Infrastrukturës, apo Drejtorisë së Shërbimeve Publike, nuk e kam të qartë.

Ju lutem dikush ua sqaroni.

Besi, rruga "Fazli Osmani".

Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

A ka dikush tjetër?

Urdhëro!

Egzon Azemi - LVV: ... të gjithë asamblastët të cilët e marrin tash mandatin e ri në ndërmarrjet publike, mirëpo desha vetëm një përmirësim të shkurtër me ia bërë Leutrim, fillimisht që këtë akuzë është dashur me ia bërë zyrtarëve të vetë partiakë, se kanë pru njerëz nga qytete tjera në Prishtinë, edhe ashtu Prishtina është kryeqytet dhe është qytet i të gjithëve, pa marrë parasysh prej cilës komunë, e rëndësishme është që secili, kush do që donë dhe është profesionalisht i gatshëm me kontribuar për kryeqytetin tonë. Edhe kjo nuk duhet me u marrë si diçka negative, por duhet me u vlerësuar madje.

Ndërmarrja Publike Banesore, e dimë të gjithë që është funksionalizuar në mandatin e qeverisjes së LVV-së, ndërsa gjatë mandateve të kaluara e dimë të gjithë se si kanë shkuar punët aty.

Faleminderit!

Kryesuesi: Ka të drejtë për replikë, dy minuta.

Urdhëro!

Leutrim Ratkoceri: Egzon, ju si zakonisht ia filloni mbrapsht, edhe me këtë zhurmë dhe me këto akuza që askush nuk ka bërë akuza, unë kërkoja transparencë dhe është mirë, Egzon, fillimisht me u nisur prej vetes, me e publikuar CV-në, kush je ti, çka bënë profesionalisht për me i shërbyer si aksionar qytetarëve të Prishtinës, dhe mos me dal te akuzat dhe subjektet tjera.

Je pozitiv dhe mësohuni me luajtur atë rol në shërbim të qytetarit edhe jo në zhurma.

Tash unë nuk e di se cilin hall e keni, a e keni atë hallin e brendshëm që po ju vlon me ua caktuar Albini drejtorët, apo Selim Pacolli, tash unë nuk mundem me ju hyrë në gjak ose nën lëkurë me e parë atë. Mirëpo me kaq sa po e shoh qeverisjen që është duke u bërë, vetëm sa më transparent i ndihmoni shumë qytetarëve, se jeni bërë një koalicion më shumë se koalicion, i çka me thënë, asnjë koalicion më i madh se deri tash nuk ka qenë në Komunë të Prishtinës.

Faleminderit!

Unë thash për transparencë, edhe njëherë, të mirëkuptohemi.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Eman Rrahmani!

Eman Rrahmani: Unë vetëm desha pak ta plotësoj Egzonin. Ne jemi të zgjedhur prej popullit edhe nuk është e arsyeshme për me e publikuar CV-në për emërimin e aksionarëve në ndërmarrjet që jemi.

Tjetër çështje është që drejtorët e ndërmarrjeve publike caktohen me konkurs, nuk emërohen prej neve, edhe nuk është e mundshme të zgjidhet prej Prishtinës apo qytetit tjetër, aty duhet me u pranuar ai i cili e meriton vendin e punës e jo të qytetit të cilit është.

Kryesuesi: Urdhëro, Adrian!

Adrian Berisha: Me insistimin e Ambasadës së Britanisë së Madhe, d.m.th. drejtorët e ndërmarrjeve publike do të zgjidhen me konkurs sa më transparent.

Përndryshe, i kisha këshilluar kësaj pjesës, në anën e djathtë timen, që sidomos Leutrim, i cili vjen nga PDK-ja, që të njëjtat akuza që po na i drejton neve me ua drejtuar bashkëpartiakëve të tij, që të jenë sa më transparentë në qeverisjen qendrore. Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, Leutrim!

Leutrim Ratkoceri: Ndoshta nuk është punë e madhe vetëm me u bërë transparent me u publikuar CV-të, nuk ju dhemb kaq shumë, Ardian.

Desha vetëm një, nuk është këtu problemi se zakonisht kjo asamble në të kaluarën e ka luajtur rolin e një mini-qeverie nacionale. Këtu jemi për Prishtinën, për qytetarët e Prishtinës edhe me i zgjidhur problemet e Prishtinës. Nuk kemi çka me u krahasuar ne me askënd, por duhet me u krahasuar këtu me vetveten edhe me u krahasuar për një shërbim më të mirë për qytetarin e Prishtinës.

Unë nuk e di çka është punë e madhe me qenë transparent, me i publikuar CV-të, edhe drejtorët kur emërohen me pasur parasysh këtë, se është një rregullore tek e fundit që e cakton.

Kërkesë është dhe në asnjë mënyrë nuk është akuzë, mirëpo me këtë gjuhën vulgare që zakonisht përmendet nga LVV-ja, nuk do të mundeni të na futni në atë grackë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro!

Eman Rrahmani: Atëherë, Leutrim, nuk e di sa e dinë sa kam informacion, se Komuna e Prishtinës është e vetmja komunë në Republikën e Kosovës, e cila fatmirësisht e ka ueb-faqen, open-data, ku ti mundesh me hyrë dhe me i shikuar të gjithat, në mënyrë transparente të gjitha informacionet që të nevojiten.

Po ashtu, duhesh me e ditur një gjë, Komunës së Prishtinës dhe çdo komunës tjetër në Kosovë, lidhet ngushtë me qeverisjen qendrore, fatkeqësisht ne jemi në vitin 2017, më falni, përveç se po e shkruaj gabim, edhe me mendje ende në 2017-ën, edhe hala nuk e kemi Ligjin për kryeqytetin, jemi i vetmi vend, kisha me thënë, në Gadishullin Ballkanik, mos të flas për vende të tjera në Evropën qendrore dhe më lart.

Po ashtu, e kemi një Pallat të Rinisë dhe është në gjendje skandaloze, e mos të flasim edhe për shumë sende të tjera, ti e dinë shumë mirë bllokimet që iu kanë bërë kryeqytetit tonë si nga PDK-ja, si nga LDK-ja, si nga të gjithë.

Kryesuesi: Urdhëro, z. Gashi!

Shefki Gashi: Faleminderit, kryesues!

Dëgjoni, tani u duk më që e keni shumicën, nuk e di pse ju ka rrokur ky stres, tash ne e dimë se paaftësia e bënë këtë, joprofesionaliteti, jogjentëllmenca, jotransparenca, mundoheni sendet me i quar. Deri tash fajtorë ka qenë LDK-ja, tash LDK-jo, fajtor tash është qeveria qendrore, qeveri qendrore e keni bërë ju këtu, ju jeni me aleancën, këtu shefin që i nget asfaltin e keni, atje i juaj është ai, a është me juve, AKR-në, Bexheti, që nget poshtë e lartë hoteleve edhe atë e keni në qeveri ju.

Prandaj ju lutem punoni në mënyrë transparente, mirë e ka kolegu lart, në mënyrë transparente, në mënyrë profesionale, është mirë me e ditur për secilin, p.sh Shefki Gashi është jurist i diplomuar, një punëtor i arsimit njëqind vjeçar e ku ta di unë etj. siç ka thënë ky djali për muze, kështu që është mirë me ditë secili ku po shkon. Nuk është e thënë me mbajtur anonim, nuk ka asgjë të keqe, jeni të ri, jeni në perspektivë.

Edhe njëherë po ju them, merreni punën vet e mos lypni me gjetur fajtor, se humbni shumë me kërkuar fajtor, sikur që keni humbur katër vjet, nuk keni punuar asgjë në Prishtinë.

Jo i keni në internet, në internet e kemi edhe Nikaraguan, e kemi edhe Beneluksin e të gjitha të tjerat, u krye ajo punë.

Prandaj, nuk ka nevojë se pasiguria është normale, se shefin nuk e keni këtu, ka ikur, ku me ditë kah ka shkuar, nuk e di kah me ia mbajtur, është e vërtet edhe kjo, por ne jemi këtu dhe dal nga dal Prishtinën ne e kemi çliruar, ne e kemi formuar, ne e kemi, ne e mbajmë dal nga dal.

Prandaj, të jeni më të qetë e mos të krijojmë raporte të këqija menjëherë në start.

Kryesuesi: Atëherë, vetëm një.

Z. Gashi, ju kisha lutur që për çështjen e CV-ve mos me diskutuar më gjatë, se do të bëhen të gjitha CV-të e të gjithë anëtarëve të Kuvendit komunal, do të publikohen e ta mbyllim këtë.

Vetëm edhe diçka. Unë në subjektin tim politik sa herë kemi mbledhje, gjithmonë jam kundër pikës "Të ndryshme", sepse aty më së shumti diskutohet dhe më së paku ka rezultate.

Ju kisha lutur, pak është edhe ari, por ka shumë vlerë, ju kisha lutur që t'i përmbahemi asaj që u mundova me e thënë në fjalimin tim, që të jemi më konstruktivë, që të jemi më parimorë.

Po, por po ka edhe fyerje e nuk kisha dashur të dëgjoj fyerje, ta themi atë që e themi e nuk kemi nevojë me fyer askënd.

Urdhëro, Egzon!

Egzon Azemi: Faleminderit, kryesues!

Shiko, është krejt në rregull me kërkuar transparencë, për këtë punë po ju arsyetoj këtë kërkesë, mirëpo mua po më çuditni edhe ti, Leutrim, edhe ju z. Shefki, qysh nuk po e dini se ne kur jemi bërë asamblastë, CV-në tonë e kemi dorëzuar së pari në KQZ, janë publike edhe në ueb-faqe të KQZ-së, janë publike edhe në ueb-faqen për Prishtinën CV-në e secilit asamblast, kështu që vetëm mundeni me hyrë dhe me i lexuar. Nëse nuk dini mirë me e përdorur internetin, që doni ua bimë herën tjetër edhe të fotokopjuar dhe i lexoni.

Por, edhe diçka, ju kisha lutur shumë me u bërë pak më konstruktivë, për shkak se jeni dy partitë më të mëdha që qytetarët i kanë njohur deri sot, jeni PDK dhe LDK, por paramendoje të dyja jeni në opozitë, të dyja jeni në opozitë dhe nuk i keni numrat.

Po ju kuptoj se ju ka rrok tash sikleti e po keni qejf me fol, por pakicë jeni, kështu që ndryshoni dhe për një mend bëhuni opozitë si duhet.

Kryesuesi: Urdhëro, Sokol!

Sokol Havolli: Desha pak, disa tema që u ngritën, vetëm sa për sqarim për qytetarët e jo për të replikuar me kolegët. E para, po më vjen keq që edhe pse janë shumicë, prapë po vazhdojnë me ankesa qysh e kanë kaluar katërvjetshin, e tash prapë njëjtë vetëm me ankesa. Mirë, krejt në rregull, nëse strategjia e juaj është vetëm me u ankuar dhe me i fajësuar të tjerët për mos punën e juaj, atëherë në rregull, është qasja e juaj, e vlerëson qytetari, në rregull është, mirë, në rregull është.

E dyta, sa për sqarim për Adrianin, sa i përket Ligjit për Prishtinën. Më falni, Adrian, apo z. Berisha, kishte me qenë më korrekte, okej, në rregull. Sa i përket Ligjit për Prishtinën, është qe tri vite që është i gatshëm, e vërtetë është kjo, mirëpo në tri vite në asnjë ditë pikërisht Komuna e Prishtinës, nuk i ka dërguar njerëzit e vetë nëpër grupet punuese me i adresuar kërkesat e veta. Vetëm ta kryej unë, mirë unë vetëm po ta sqaroj, sepse duhet me e njoftuar qytetarin drejt, Komuna e Prishtinës nuk i ka dërguar njerëzit e vet nëpër grupet punuese që kanë qenë në nivelin qendror, edhe arsyeja ka

qenë sigurisht që nesër kur shkon Ligji për Prishtinën, me thënë jo ky ligj nuk i plotëson ose i plotëson kërkesat.

Njëjtë edhe sot për Pallatin e Rinisë, ne i shohim që 2-3 shou-medial të kryeministrit dhe kryetarit të Komunës që u bë marrëveshja për Pallatin. Marrëveshja për Pallatin, që edhe këtu një këshillë, sidomos për Zyrën ligjore, por edhe për kryetarin, Ju lutem, në komisionet parlamentare në Kuvendin e Kosovës bëni plotësim-ndryshimin e Ligjit për Prishtinën, përfshijeni aty edhe Pallatin e Rinisë, se vetëm me një vendim të qeverisë nuk keni me mundur me e marr atë, sepse është në kompetencë të AKP-së.

Prandaj, dërgojini njerëzit le të punojnë me komisionet parlamentare, le të propozojnë amandamentimin e Ligjit për Prishtinën edhe le ta përfshijnë në atë ligj.

Gjithashtu edhe sa i përket Ambasadës britanike, këtu Ambasada britanike ose përfshihet përmes Kompanisë BDO në zgjedhjen e drejtorëve të ndërmarrjeve publike, ose nuk përfshihet. Kjo do të thotë 0 edhe 1, nuk ka këtu kërkesa e këto se kërkesat për transparencë vijnë prej të gjitha institucioneve, prej të gjitha rregulloreve këtu.

Mirëpo ne duhet ta kemi të qartë të na tregojë ekzekutivi i Komunës se a është e përfshirë BDO-ja, a do të jetë pjesë e procesit të përzgjedhjes së drejtorëve të ndërmarrjeve publike, apo vetëm e lëshoj një muhabet këtu kolegu ynë, që edhe ajo është në rregull, nuk prish punë, mirëpo ne duhet ta dimë dhe ta kemi të qartë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, Mimoza!

Mimoza Sylejmani: Desha me e sqaruar kërkesën, se edhe unë i takoj asaj lagjeje që zotëria e tha, e di saktësisht ku është hyrja, është dy hyrje më poshtë se unë ku jetoj edhe e di që ka qenë, se edhe unë e kam të njëjtin problem, por kjo është më shumë prej keqpërdorimit të ne vetë qytetarëve, se po zihet tërë kohën me mbeturina, edhe ka qenë disa herë Komuna, ka qenë z. Halil Halili, i kanë dërguar, si jo, kanë qenë vitin e kaluar e sivjet nuk jam e informuar, se edhe unë i kam thirr për të njëjtin problem që e kemi.

Edhe unë i kam thirr, se dy hyrje më lartë se ju jam edhe e kemi të njëjtin problem, po që nuk po e di, kam me u interesuar edhe unë edhe a kemi kontratë për këtë gjë.

Kryesuesi: Faleminderit shumë!

Vlora Dumoshi: ... bodrumi është mbushur, zonja mirë e ka, e cila banon në atë lagje, është puna e neglizhencës së Komunës, Inspeksionit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ne jemi bërë banorët me dalë prej banesave, sepse kanalizimet e kafiqave të cilat zihen edhe hyjnë ata pronarët edhe i prenë edhe krejt fekalet shkojnë në bodrum. Bodrumi ka arritur në 1 metër e 20 centimetra, ku gjysmë metri është fekale e zezë. Asnjë banor nuk mundemi as me zier, sot i ka ardhur edhe ujit era kanalizim, sepse ndoshta edhe gypat aty korrespondojnë njëra me tjetrën edhe ne nuk mundemi as me fjetur, as me zier e as me ngrënë, nuk po dimë më se çka të bëjmë.

Mbi 30 fëmijë janë të moshës prej 1 muajsh deri në moshën 15 vjeçe të cilët kalojnë andej.

Unë kërkoj, është punë e qytetit, është punë e qytetarit, është punë e shëndetit, aty epidemi do të bëhet. Unë kam rastisur që jetoj në atë hyrje, por përveç meje jetojnë edhe 45 familje të tjera. Unë e lus atë zonjën e cila i mori shënimet, e cila nuk e pa aq problematike me gjestin e saj, lus edhe kryetarin e Prishtinës që të na dalë në ndihmë momentalisht banesës për të cilën jam kah foli, por edhe ndërtesave të tjera, sepse gjendja është emergjente.

Unë kam kërkuar edhe prej televizioneve që me e bërë publike, edhe qytetarët e pandërgjegjshëm të kafeterive duhet t'i dënojë inspeksioni, kjo është gjendje emergjente.

Drejtorja për Shërbime Publike, zotëri, të cilën nuk ke të drejtë me fol dhe me më dhënë përgjigje, mbaje në mend, në çoftë se luan ndonjë rol, më ka thënë që ende nuk i keni kompanitë, nuk i keni bërë kontratat për këto shërbime, por pasi që është një gjendje alarmante, ju lutem, kërkoj nga ju që menjëherë një ekip të shkojë dhe ta incizojë situatën. Përveç situatës, hyni edhe nëpër banesa lëshojeni ujin dhe shikoni sa është ai ujë i pastër edhe shikoni kundërmimin i cili është hyrë brenda në banesa.

Faleminderit shumë!

Kryesuesi: Fjalën e ka Fitnete Bejta.

Fitnete Bejta: Faleminderit për fjalën!

Sinqerisht, ne kemi menduar që kjo fitorja e juaj e "koalicionit kallaballëk" prej shumë partive, fitore dramatike, sepse kemi një diferencë prej partisë së parë dhe të dytë, me sa e di unë, nëse nuk gaboju, edhe prej fitores është 0.32%, që i bie për pak vota e jo për shumë. Megjithëse ju keni pritur me pasur shumë krah edhe me pasur një fitore bindëse, për shkak të propagandës edhe asaj euforisë së pushtetit që e keni pasur për katër vjet, mirëpo ju nuk keni marrë mësim prej kësaj fitores së ngushtë me neve, po e shoh se po e vazhdoni atë kursin e bllokimit, injorancës dhe fyerjes kundër kandidatëve. Secili asamblist përfaqëson dikë këtu e nuk jemi duke përfaqësuar vetveten, por diçka ...

Sa i përket ueb-faqes së Komunës, desha të ju njoftoj se ueb-faqja e Komunës nuk është e përgjithësuar, madje ka vonesë në përgjithësi me muaj, sepse ju mundeni me hy tash në ueb-faqen e Komunës edhe me e parë që aty janë aktual asamblistët e mandatit të kaluar, ku disa prej tyre edhe nuk janë në mesin tonë.

Nuk jeni transparent, sepse parimet e mirëqeverisjes dhe demokracisë ... transparenca, respektimi i kundërshtarit politik etj.

Pakicë, shumicë, këto janë terma shumë kisha thënë nënçmues, edhe ju kisha lutur që këto terma pakicë dhe shumicë mos t'i referojmë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, z. Stavileci!

Blerand Stavileci: Unë po i përmbledhi në 2-3 pika. E para, kjo që lidhet me kërkesat, besoj se të gjithë e dimë edhe qëllimin, por edhe gjuhën shqipe për ta dalluar kërkesën prej akuzës, prej kundërshtimit etj. Mendoj se është kërkesë e mirë nëse duan ta zbatojnë e zbatojnë, nëse nuk duan është punë e tyre, por sipas logjikës që diçka ekziston te KQZ-ja, i bie që as kryeministri, as ministrat, as drejtorët asnjëherë të mos e publikojnë në ueb-faqe dhe t'u thuhet qytetarëve shko gjeje te KQZ-ja. Mendoj që është kërkesë e mirë, e drejtë, pa qëllim akuze ose kundër akuze ndaj dikujt, e para.

E dyta, kisha pasur ndoshta një propozim, edhe pse atë e precizon neni 43 i ligjit, meqenëse dihet se duhet të ketë një numër minimum prej dhjetë mbledhjesh në vit të Kuvendit, ndoshta kishte me qenë mirë që bashkërisht ta bëjmë një plan vjetor dhe ndoshta orientimisht t'i caktojmë, meqenëse janë dhjetë dhe kërkohen pesë të tilla në gjysmën e parë të vitit, të paktën deri në qershor, dhe ndoshta të dakordohemi që të jetë nëse është dita e enjte, sado që unë këtu kam hamendje, meqenëse që zakonisht të enjteve mbahen edhe mbledhjet e Kuvendit, atje ndoshta e premtja apo e mërkura ta mendojmë, por të ketë orientimisht mënyrë që të gjithë të përgatitemi më mirë, edhe ne edhe ekzekutivi.

Dhe e treta, është një kërkesë, duke u nisur nga ajo që të gjithë duam ta shohim vendin tonë të pastër, dhe parëz pati disa kërkesa që lidhen me mirëmbajtjen dhe direkt dhe indirekt me higjienën, që janë të rëndësishme për të gjithë neve, mendoj se është mirë shumë që të zgjidhen ato nëpër lagje. Por, para se të dilet atje, kolegë unë sot hyra tek ky tualeti këtu, i ftoj edhe mediat edhe juve ta shihni se në çfarë gjendje është, dhe mendoj se duhet të intervenohet sa më shpejt. Aty frekuentojnë qytetarët edhe të gjithë ne, me të vërtetë është një gjendje katastrofale, e papranueshme, jo në kuptimin estetik, tek e fundit mos të jetë e bukur, por të jetë e pastër, e aty ishte e kundërta e saj. I ftoj edhe mediat të shkojnë dhe të shohin, kështu që mendojnë se edhe njëra edhe tjetra lidhen me atë që të gjithë ne e kemi synim, sidomos edhe premtimet të cilat i kanë dhënë për një Prishtinë të pastër, dhe nëse nuk nis kjo prej shtëpisë sate, atëherë është problem që të zbatohet edhe diku tjetër.

Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!

Urdhëro, Drilon!

Drilon Pireva: Faleminderit!

Desha me e bërë një sqarim lidhur me problemin që u shtrua këtu lidhur me kanalizimin. Ligji për bashkëpronësi na tregon që banesat në bashkëpronësi tashmë janë të pronarëve privatë, dhe rrjedhimisht i bie që parane publike nuk mundesh me investuar në pronë private. Do të thotë, në pjesën ku është në bashkëpronësi të pronarëve privatë nuk mund të investohet paraja publike. Për këtë arsye është bërë edhe prej Ndërmarrjes Publike Banesore një projekt, ku është në bashkëpunim me

banorët mirëmbajtje e hyrjeve banesore, edhe ky projekt është duke vazhduar shumë mirë. Por, po dua me ju treguar që këto probleme nuk janë tash, por këto probleme janë që prej pasluftës, degradimi më i madh ka ndodhur për shkak të ndërtimeve pa leje, gjithashtu lokalet, po përmenden gjithashtu mbindërtimet, ku tash këta gypat e kanalizimit nuk mund t'i përcjellin kapacitetet e reja që janë nëpër lagje.
Faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit!
Urdhëro, z. Agim Gashi!

Agim Gashi: Ne ngritëm një rast që ka ndodhur në lagjen "Dardania", por shqetësimi është se që kur i është telefonuar Shërbimeve publike, përgjigja ka qenë se Komuna nuk ka kompani të kontraktuar për ndërhyrje dhe marrja e një përgjigje të tillë flet për një papërgjegjësi totale, sepse Komuna ka në pronësi me qindra objekte publike, siç janë shkollat dhe objektet tjera, por janë edhe objektet e qytetarëve të Prishtinës që janë në bashkëpronësi dhe në situatat kur bashkëpronarët nuk mund ta zgjidhin problemin ndërhyrja institucioni. Dhe kjo nuk e arsyeton, Ligji e rregullon jetën e bashkëpronësimit, por nuk e arsyeton mosndërhyrjen në situatën emergjente, sepse kjo nuk ka ndodhur që një natë, por që disa net, edhe ju mos harroni se kryetari i Komunës është përgjegjës për sigurinë e qytetarëve në komunën e Prishtinës, është personi i vetëm kompetent që jep urdhër dhe e zgjidh problemin, pastaj vazhdojnë proceset tjera për ta identifikuar fajtorin, për të marr masa ligjore ndaj atyre që i kanë bërë ato gjëra, sepse nuk mund ta viktimizojmë një kolektivitet për shkak të neglizhencave apo mosfunksionimit të jetës institucionale.

Po më vjen keq që nuk janë njerëzit kompetentë me e dëgjuar këtë, sepse çka nëse sot një shkolle i bllokohet kanalizimi, a duhet me prituri derisa të nënshkruhet kontrata me një kompani, ka edhe procedura shtesë që e rregullojnë këtë punë, por Komuna duhet me i shfrytëzuar ato kompetenca.

Prandaj edhe këtu shfrytëzoni kompetencat dhe u dilni në ndihmë atyre qytetarëve.
Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, Vlora!

Vlora Dumoshi: Agimi e tha, por mua po më vjen keq për kolegët e mi të cilët do të punojmë së bashku tash katër vjet, do të bashkëpunojmë, unë jam për bashkëpunim, edhe e respektoj votën të cilën na e kanë dhënë qytetarët.

Problemi është vetëm te shpërthimi i ndonjë epidemie, kjo është ajo, pastaj ka pasoja më të mëdha, dijeni që ato banesa janë ato banesa te Santea. Në çiftë se ju vini me mua, secili prej juve, ju do ta shihni një gjendje e cila është e tmerrshme. Unë kam rastis që jam aty banore, unë e kam shtëpinë te prindërit e mi edhe shkoj, por njerëzit e tjerë nuk kanë ku të shkojnë.

Ju betohem se asnjë njeri nuk mundet me fjet në shtëpinë e vet, vetëm po e kërkojnë një ndihmë prej institucionit, që le të vjen dhe ta shikojë, kjo është, e jo me na qit

rregullore të banesave e kemi bërë kolegu që e tha kërkesën, por deri në maj Ndërmarrja Banesore nuk mundet me ardhur dhe me proceduar për rregullimin e kanalizimit sepse ka të tjera.

Kështu që kjo është emergjente, Komuna e Prishtinës duhet ti dalë kësaj pune në krye.

Kryesuesi: Po, z. Kukaj, vetëm të shohim a ka edhe diçka tjetër e pastaj jepni përgjigje. Urdhëro, z. Havolli.

Sokol Havolli: Është në interes të secilit prej neve që jemi këtu, por edhe në interes të ekzekutivit, që me shkuar dhe me adresuar atë problem, sepse mos të na përsëriten situata dhe tragjedi që i kemi pasur herën e kaluar, në mandatin e kaluar, e pastaj të gjejmë arsyetime për ato çështje. Është çështje shumë teknike që me mekanizma relativisht të thjeshtë adresohet edhe është në interes të juaj me u adresuar ajo çështje edhe në interes të banorëve, kështu që mos të gjejmë arsyetime as te ligji, se unë jam për zbatim të ligjit prej A deri në ZH. Pa kurrfarë tentative me i ik jashtë asaj, mirëpo ka hapësirë çoftë përmes Ndërmarrjes Publike Banesore se, megjithatë Ndërmarrja Publike Banesore ndërhyr në objektet e përbashkëta që janë pronë e përbashkët, por edhe shërbimet komunale këto çështje i adresojnë, prandaj nuk duhet të lejojmë të na përsëriten tragjedi që kanë ndodhur vitin e kaluar për shkak të neglizhencës së Komunës.

Kryesuesi: Faleminderit!
Urdhëro, z. Dren!

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës: Faleminderit, kryesues!

Unë isha pajtuar këtu me Drilonin, në raport me konstatimin e tij lidhur me kompetencat e Komunës, edhe është e qartë se në rastet e tilla Komuna nuk gëzon kompetencë për me ndërhyrë në zgjidhjen e problemeve të tilla.

Mirëpo, nëse situata është e tillë dhe emergjente edhe për shkak se nuk jemi të përfaqësuar këtu prej dikastereve që e kanë këtë kompetencë, unë i kam dy orë të lira edhe nëse vërtet është ashtu, unë po vij me ju atje edhe ma merr mendja që për dy orë e dimë njëfarë rrugëdalje. A e bëjmë me Ndërmarrjen Banesore, a e bëjmë me qytetarët apo e bëjmë ne si Komunë, sido që të jetë, në ora dy kam takim, e deri atëherë jam i lirë, unë vet po e marr përsipër dhe po dal kështu përtej kompetencave të mia që me adresuar këtë çështje nëse jeni dakord.

Kryesuesi: Faleminderit!

A ke ndonjë çështje tjetër me ngritur.

Po e ke pasur replikën dhe e ke përdorur, nuk thotë sa herë të përmendet emri.

Sot, të ju them të drejtën, është seanca e parë edhe nuk jam kah e shikoj shumë mirë për me ju përmbajtur strikt rregullores, se këtu ka pasur momente kur është diskutuar, të them të drejtën që është dashur me ndërprerë menjëherë.

Te fjala të ndryshme, te pika "Të ndryshme", merret për me ngritur probleme, e jo për me u ofenduar në mes vete subjektet politike. Kjo nuk është punë e Komunës, subjektet

politike janë arenat tjera ku munden me u përballë, këtu vetëm çështje të Komunës, prandaj ju thash sot është hera e parë dhe e lëshuam pak dorën, por herëve të tjera ju lutem vetëm brenda rendit të ditës, përndryshe unë ua ndërpres fjalën.

Faleminderit!

Urdhëro, të lutem!

Leutrim Ratkoceri: Faleminderit, kryesues!

Por, dita e mirë shihet në mëngjes, edhe pse është seanca e parë, ne duhet me i pasur rregullat parasysh.

Nëse unë e bëjë një kërkesë, nuk mundem me u quajtur prej palës tjetër se po bëjë akuzë, aty ti duhesh me ndërhyrë, edhe sa herë të më përmendet emri, Leutrim, unë kam me marr fjalën.

Dëgjo, katër vitet e kaluara kanë qenë humbje kohe për qytetarët e Prishtinës, duke u marr këta me akuza dhe me shpifje, më nuk ka me shkuar ashtu, kryesues.

Nëse donë me qitur rregull, qit rregull, për qytetarin e jo për palët këtu.

Edhe desha me u ndërlidhur, zotëria i parë që ma citoi emrin së pari, tha nuk po di me lëshuar mikrofonin e pastaj filloi me më mësuar mua diçka, për muzikë mundet me më treguar diçka, e për këto sendet tjera jo.

E dyta, ky cituesi i dytë tash, se unë emrin nuk jua përmendi, nëse tha për me fol për internet kush e njëh internetin qysh e njëh, më së paku mundet me ngritur edhe gisht edhe me na fajësuar neve si PDK në Prishtinë, edhe mua posaçërisht si Leutrim.

Këto gjëra le t'i marrin e le t'i kultivojnë në kulturën e tyre e jo këtu në asamble, se sa dinë këta ne e dimë më mirë, këta dinë me gjuajtur me zolla, dinë me i pasur kolegët nëpër burgje për terrorizëm, kaq dini ju.

Unë me kaq po e përfundoj, dhe sa herë të më përmendet emri, kryesues, duhem me e marr fjalën se është rregull edhe replikoj.

Kaq pata me thënë.

Faleminderit!

Kryesuesi: Urdhëro, Vala Peshku!

Vala Peshku: Tash d.m.th. nuk ke durim me dëgjuar, a po?

Qe pesë minuta jemi duke pritur me treguar për kërkesën për problemin në Dardani, e ti je kah merresh me vetveten, nuk është ky Kuvend për ty por për Prishtinën.

Kryesuesi: Faleminderit!

Atëherë, ju falënderoj për pjesëmarrje, e për mbledhjen e radhës ju njoftoj me kohë.
Faleminderit!

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.